



DREJTORIA E BUJQËSISË
UPRAVA ZA POLJOPRIVREDU
DEPARTMENT OF AGRICULTURE

Tel/Fax: 0290 322 922
Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

DATA/DATUM/DATE	05.05.2025
NR/BR.	11/23
PËR/ZA/TO	Tabelën e shpalljeve
NGA/OD/FROM	z. Burim Bajrami Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Thirrje për aplikim

Thirrje për aplikim

Drejtoria e Bujqësisë - Ferizaj në bazë të Vendimit nr.11/12 të datës 03.03.2025 do të realizojë projektin: **Furnizimi i fermerëve me fidane të mjedrës dhe sistem të ujitjes**. Përfitues do të jenë 8 fermerë me sipërfaqe nga 0.25 ha.

Përkrahja do të jetë në : Sigurimin e fidaneve të mjedrave, folinë dhe sistemin e ujitjes për ato sipërfaqe që do të ngriten.

Për të qenë përfitues fermerët duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Të jetë banor i komunës së Ferizajt;
- Pronën ta ketë në komunën e Ferizajt;
- Të ketë aplikuar sipas kushteve të kërkuara;
- Të ketë mundësinë për ujitje të pemishtes;
- Të posedoj tokë të përshtatshme për kultivimin e mjedrës;

Përparësi kanë :

- Fermerët që kanë përgatitje profesionale, përvojë apo njohuri të mjaftueshme rreth kultivimit të mjedrave,
- Të papunësuarit,
- Të rinjtë.

Fermerët e interesuar për ngritjen e pemishteve me mjedra do të aplikojnë në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve – Komuna e Ferizajt.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Fotokopjen e letërnjoftimit;
- Fletëaplikacioni i plotësuar (që mirret në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve);
- Çertifikatën për pronësi të tokës (fletën poseduese) origjinal, jo më të vjetër se 6 muaj;

Afati për aplikim fillon nga data 05.05.2025 deri më 16.05.2025.